

lejuar, janë bërë publike, sipas ligjit, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, pjesa e posaçme për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Në lidhje me vendet vakante me organ emërtese Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar Listat Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të Lejuar, si më poshtë:

1. Për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarit Vladimir Kristo, në përfundim të procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, me vendimin nr. 130 datë 21.09.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur:

“Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 12.02.2018, si më poshtë :

- | | |
|----------------|--------------|
| 1) Arta Vorpsi | 89.642 Pikë |
| 2) Elsa Toska | 85.428 Pikë |
| 3) Besnik Muçi | 81.928 Pikë” |

2. Për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019, për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarit Bashkim Dedja, në përfundim të procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, me vendimin nr. 134 datë 21.09.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur:

“Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019, si më poshtë :

- | | |
|---------------------|--------------|
| 1) Arta Vorpsi | 89.642 Pikë |
| 2) Fiona Papajorgji | 88.785 Pikë |
| 3) Elsa Toska | 85.428 Pikë” |

Në lidhje me vendet vakante me organ emërtese Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar Listat Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të Lejuar, si më poshtë:

1. Për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 10722 datë 07.02.2018, për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi, në përfundim të procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, me vendimin nr. 128 datë 21.09.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur:

“Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2019, si më poshtë :

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**
Adresa Elektronike : **Keshilli5@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

- 1) *Arta Vorpsi* 89.642 Pikë
- 2) *Elsa Toska* 85.428 Pikë
- 3) *Besnik Muçi* 81.928 Pikë
- 4) *Regleta Panajoti* 80.285 Pikë”

2. Për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11133 datë 04.03.2019, për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarës Altina Xhoxhaj, në përfundim të procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, me vendimin nr. 132 datë 21.09.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur:

“Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, si më poshtë :

- 1) *Arta Vorpsi* 89.642 Pikë
- 2) *Fiona Papajorgji* 88.785 Pikë
- 3) *Elsa Toska* 85.428 Pikë
- 4) *Marsida Xhaferllari* 82.000 Pikë”

Në lidhje me përmbylljen e procedurave kushtetuese e ligjore për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10722 datë 07.02.2018, për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi, ju informojmë se:

- Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11313 datë 15.10.2019, ka emëruar zotin Besnik Muçi gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.
- Për këtë qëllim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, është vënë në dijeni me shkresën e dërguar nga Institucioni i Presidentit të Republikës me nr. 3665 prot datë 16.10.2019, administruar pranë Këshillit me nr. 678 prot datë 17.10.2019.

Në lidhje me përmbylljen e procedurave kushtetuese e ligjore për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11133 datë 04.03.2019, për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarës Altina Xhoxhaj, ju informojmë se:

- Sipas Kushtetutës dhe ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka përmbushur të gjitha detyrimet kushtetuese e ligjore, në ushtrimin e funksioneve të tij, duke i dërguar Presidentit të Republikës, në datën 08.10.2019, Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve, së bashku me Raportin e Arsytuar për këtë renditje për vendin vakant të shpallur prej Tij në datën 04.03.2019, gjë e cila është bërë edhe publike.
- Me shkresën nr. 553 datë 08.10.2019, me lëndë *“Për dërgimin e Listës Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe të Raportit të Arsytuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11133 datë 04.03.2019”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka dërguar Institucionit të Presidentit të Republikës sa më poshtë :

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019

Adresa Postare : ***GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : ***Keshilli5@ ked.gov.al*** Numra telefonikë : ***+355 4 2257302***

- Vendimi nr. 132 datë 21.09.2019 “Për Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”;
- Vendimi nr. 133 datë 21.09.2019 “Për miratimin e Raportit për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”
- Raporti për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019;
- Lista Treguese dhe aktet përkatëse (a) të lejimit të kandidimit dhe (b) të vlerësimit e të pikëzimit të kandidaturës për secilin kandidat të lejuar për kandidim, (c) aktet e përfundimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës për kandidatët e tërhequr nga kandidimi, si edhe (ç) aktet e ndalimit të kandidimit për kandidatë që nuk përmbushën kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit.
- Sikurse tregohet në shkresën nr. 3535/1 datë 05.11.2019 të Presidentit të Republikës, kjo praktikë dokumentare është administruar prej Institucionit të Presidentit të Republikës me nr. 3535 prot datë 08.10.2019.
- Në referim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të nenit 7/b, pika 4 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ndryshuar me ligjin nr.99/2016), duke qenë se afati 30 ditor i parashikuar nga këto dispozita përfundon në datën 07.11.2019, ditën e sotme dhe deri në çastin e dërgimit të këtij informacioni, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk ka ardhur ndonjë njoftim nga Institucioni i Presidentit të Republikës për ushtrimin e së drejtës së Presidentit të Republikës për të emëruar një nga tre kandidatët e renditur në Listën që ka miratuar Këshilli me vendimin e sipërcituar me nr. 132 datë 21.09.2019.
- Gjithashtu, edhe në faqen zyrtare të Presidentit të Republikës, në ditën e sotme, nuk rezulton të jetë bërë publike ushtrimi i së drejtës nga Presidenti i Republikës për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur me dekretin nr. 11133 datë 04.03.2019.
- Nëse i referohemi ligjit, në respekt të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000 (i ndryshuar), që kanë sanksionuar se “Nëse Presidenti nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.”, sipas Vendimit me nr. 132 datë 21.09.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kandidatja e renditur e para në Listën Përfundimtare, Znj. Arta Vorpsi konsiderohet e emëruar si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin

KRYETARI

Ardian Durrani



Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (I Përkohshëm) 2019

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **Keshilli5@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**